

Nr. 05/24

Datë: 18/01/2024

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publike, nenit 3 pika 3 të Statutit nr.01-979/2023 të datës 25.04.2023 të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Posta Kosovës” Sh.A - Prishtinë, Bordi i Drejtorëve i NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A. në mbledhjen nr. 01/2024 të mbajtur më datë 18.01.2024, mori këtë:

### V E N D I M

1. Ndryshohet dhe Plotësohet Paragrafi 7.3. i nenit 7 i Rregullores për Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendit të Punës në Nivel Qendror nr.01-1974/17 e datës 27.07.2017 si në vijim:

Pozita: Auditor/e i/e Brendshëm/e

Mbikëqyrës: Zyrtari/ja i/e Auditimit të Brendshëm

Grada: 10

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale dhe ruan certifikimin e vet profesional, duke marrë pjesë në 60 orë trajnim brenda dy viteve të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara të Ligjit nr. 06/L-021;
- Përgatit planin për njësinë (departamentin) për auditim;
- Siguron cilësi të angazhimeve të auditimit;
- Përgatit letra të punës në lidhje me auditimin e kryer;
- Përpilon dhe përgatit nivelin e rreziqeve, të cilat duhet t'i kryejë gjatë auditimit;
- Jep rekomandime adekuate për njësinë/departamentin e audituar;
- Kryen auditim të rregullsisë financiare, operative, ligjore, performancës, përcjelljes, etj;
- Zbaton detyrat dhe përgjegjësitë sipas plan-programit dhe kërkesave shtesë, të cilat mund të delegohen nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm i NJAB [ZAB];
- Përgatit dhe adapton pyetësorët sipas aktivitetit auditues;
- Nxjerr mostra sipas gjykimit profesional ose metodave tjera relevante;
- Mbledh dhe analizon të dhënat;
- Mban takimin përmbyllës të auditimit;
- Përgatit draft-raportin dhe raportin përfundimtar të auditimit;
- Përgatit raporte të qarta dhe koncize të auditimit;
- Përcjell implementimin e rekomandimeve të dhëna;
- Verifikon rregullisht përshtatshmërinë që ka për qëllim që të sigurojë se dokumentacioni financiar, ligjor mbahet në përputhje me standardet, rregullat dhe ligjet përkatëse;
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave, të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë;

- Raporton për aktivitetet audituese tek ZAB;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga ZAB.

### **Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:**

- Të ketë diplomë universitare në ekonomi, financa, kontabilitet, administratë publike, juridik apo të ngjashme;
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit ose kontabilitetit, menaxhimit financiar;
- Të jetë auditor i brendshëm i certifikuar sipas nenit 22 pika 2.2 të Ligjit nr. 06/L-021, njohës i mirë i sistemit financiar, kontabël;
- Të zhvillojë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, si dhe të ruajë certifikimin sipas nenit 25 pika 1.3 të Ligjit nr. 06/L-021;
- Të ketë njohuri nga fusha e qeverisjes korporative dhe financiare;
- Të ketë njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme për analizim dhe definim të problemeve, fakteve dhe për dhënie të rekomandimeve dhe konkluzioneve të bazuara në dëshmi;
- Të demonstrojë aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me Menaxhmentin dhe stafin e ndërmarrjes;
- Të ketë shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (word, Excel, PowerPoint).

1. Vendimi hynë në fuqi ditën e protokollimit në arkivin e ndërmarrjes.

### **A r s y e t i m**

Bordi i Drejtorëve sipas rregullit më datë 18.01.2024 ka mbajtur mbledhjen nr.01/2024, ku si pikë nr.6 kishte pikën “*Plotësim/ndryshim i rregulloreve*” .

Me qëllim që përshkrimi i detyrave të punës dhe kriteret e pozitës së punës Auditor/e i/e e paraparë me Rregullores për Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendit të Punës në Nivel Qendror nr.01-1974/17 e datës 27.07.2017 të jeni në harmoni me kërkesat e Komisionit të Auditimit dhe kërkesat ligjore, Bordi I Drejtorëve duke u bazuar dhe në vendimin nr.01-2224/2023 të datës 19.09.2023 të Komisionit të Auditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesë e Bordit të Drejtorëve  
 Hyrmet Mydyti



I dërgohet:

- 1x Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve;
- 1x Kryeshefit Ekzekutiv të PK-së;
- 1x KP/SK të PK-së;
- 1x Aksionarit – NJPMNP;
- 1x Resurseve Njerëzore;
- 1x Arkivës të PK-së.